

„Kompetent i gjuhës që nga fillimi“ – Fleta udhëzuese U6 Këshilla për praktikimin e shumëgjuhësisë në familje

Të dashur prindër,

Fëmija Juaj i ka mbushur një vit dhe tashmë ka mësuar të rrotullohet, të qëndrojë në këmbë, të ecë këmba-dorës dhe së shpejti do do të marrë guximin t'i hedhë hapat e para. Edhe në zhvillimin e tij gjuhësor kanë ndodhur shumë gjëra. Fëmija Juaj i kupton disa fjalë, e ndoshta edhe disa porosi/detyra të vogla. Ai mund formojë shumë tinguj, të gugasë dhe tashmë mund të provojë t'i thotë fjalët e para.

Në vazhdim i keni informacionet për praktikimin e mëtejshëm të shumëgjuhësisë dhe lexoni këshillat e rëndësishme, se si duhet ta mbështetni fëmijën Tuaj gjatë mësimit të gjuhës.

Në qoftë se fëmija Juaj së pari e mëson vetëm gjuhën amtare (gjuhën e nënës)

- **Me fëmijën Tuaj edhe më tej flisni në gjuhën, të cilën Ju e zotëroni më mirë.** Për fëmijën Tuaj është shumë e rëndësishme të dëgjojë shembuj gjuhësorë korrektë. Sa më i madh të jetë thesari (leksiku) gjuhësor, aq më lehtë do të jetë për fëmijën Tuaj që ta mësojë gjermanishten si gjuhë të dytë.
- **Shfrytëzoheni çdo rast, në të cilin fëmija Juaj do të mund të dëgjojë gjuhën gjermane.** Fëmija Juaj sa më herët që të vijë në kontakt me gjermanishten, aq më lehtë për të do të jetë mësimi i kësaj gjuhe. Meqë fëmijët gjuhën më lehtë e mësojnë duke luajtur, do të ishte mirë që Ju me fëmijën Tuaj të vizitoni, p.sh. një grup fëmijësh të vegjël (grupin e çamarrokëve, korin e këngëve të fëmijëve, gjimnastikën e fëmijëve).
- **Një vizitë e hershme e një çerdheje ose një kopshti për fëmijë ofron shansin më të mirë për mësimin e gjermanishtes.**

Në qoftë se fëmija Juaj rritet me më shumë gjuhë

- **Është e rëndësishme që të dy prindërit me fëmijën të flasin edhe më tej në gjuhën e tyre amtare.** Si zakonisht fëmija më herët flet në

atë gjuhë të cilën e dëgjon më shpesh. Kjo është krejtësisht normale. Është me rëndësi që me atë rast prindi tjetër të qëndrojë në gjuhën „e tij“, sepse fëmija është i pasigurt.

- **Mos u shqetësoni nëse fëmija Juaj i përziën/ngatërron gjuhët.** Ndodh shumë shpesh që fëmijët t'i përziejnë gjuhët dhe p.sh. bukës (gjermanisht) „Brot“, në shqip i thonë „Butter“. Kjo nuk prish punë, pasi që kjo është një shprehje e kompetencës (aftësisë) së lartë gjuhësore. Me atë rast përsëritni edhe njëherë të dy fjalitë në gjuhën Tuaj, pa mos kërkuar nga fëmija që ai t'i përsëritë këto.
- **Nëse nuk ka person referimi që me fëmijën flet gjermanisht, atëherë kon-**

takti në gjuhën gjermane do të ishte shumë i rëndësishëm.

Të respektohet gjuha amtare përkatëse dhe gjuha gjermane

Tregoni fëmijës Tuaj se Ju jeni krenar me gjuhën Tuaj amtare, por gjithashtu tregoni se sa e rëndësishme është zotërimi i gjuhës së shtetit në të cilin Ju jetoni. Se sa me qejf dhe para së gjithash, sa mirë do t'i mësojë fëmija Juaj gjuhët e ndryshme, kjo varet shumë nga fakti se a do t'i vlerësojë të gjitha gjuhët pozitivisht dhe a do t'i flasë ato aktivisht. Për shembull, nëse Ju gjatë blerjes flisni gjermanisht, por brenda familjes flisni në gjuhën Tuaj amtare, atëherë fëmija Juaj këtë që nga fillimi do ta ndjejë krejtësisht normale.

Pra, fëmija Juaj mund ta bëjë këtë

10.–14. muajsh

I kupton disa fjalë dhe porosinë e vogla, i shqipton fjalët e para, e pastaj dalëngadalë e zgjeron vokabularin/leksikon gjuhësor (Gjatë një zotërimi paralel të më shumë gjuhëve, fjalët e para ngandonjëherë i prodhon pak më vonë)

Nga mosha 18 muajshe

Ndodh mësimi i shpejtë i fjalëve të reja dhe formimi i parë i kombinacioneve me fjalë

Kështu mund ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin e gjuhës

- **Emërtoni më shpesh sendet dhe veprimtaritë.** Fëmija Juaj para se ta kuptojë një fjalë të re dhe më vonë të mund edhe vetë ta shqiptojë, ai këtë fjalë duhet ta dëgjojë më shpesh nga Ju. Shembull: Kur fëmija Juaj gjatë lojës së përbashkët nga kutia e lodrave rregullon më shumë gjëra, emërtoni këto gjëra: „Ah, këtu është një qen.“ „Oh, ti paske një veturë.“
- **Flisni ngadalë, qartë dhe theksojeni fjalën e rëndësishme në fjali.** Kështu do t'ia lehtësoni fëmijës Tuaj të kuptojë fjalë të reja dhe ato t'i fiksojë në mendje. Së shpejti fëmija Juaj do të provojë krejt spontanisht që vetë t'i shqiptojë këto fjalë.
- **Reagoni pozitivisht ndaj këtyre përpjekjeve gjuhësore të fëmijës Tuaj, qoftë edhe nëse ai nuk i shqipton korrekt ato fjalë.** Në fillim të mësimit të gjuhës është tejet e rëndësishme që fëmija Juaj të ndjejë kënaqësi për gjuhën. Prandaj ai me gjithë qejf do të shërbehet me gjuhën e fëmijëve, si p.sh. ham-ham. Kuptojeni këtë pozitivisht dhe veç kësaj fëmijës ofrojani/servojani fjalinë. „Po, një qen që bën ham-ham.“
- **Me fëmijën Tuaj filloni të vështroni libra të thjeshtë me ilustrime.** Tregojani dhe emërtoni sendet në libër. Jepni fëmijës Tuaj pak kohë që edhe ai vetë t'i shikojë ilustrimet dhe emërtojani sendet të cilat ai i shikon/i tregon.